



**QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR**

**RAPORT VJETOR**  
për punën e Qendrës për zhvillim të RPJP  
për vitin 2018

**Janar 2019**

## HYRJE

Me Marrëveshjen për bashkëpunim në mes Ministrisë së vetëqeverisjes lokale dhe njësive të vetëqeverisjeve lokale nga rajoni planor Jugperëndimor, themelues të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, janë përcaktuar aktivitetet dhe detyrat e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në vitin 2018.

Aktivitetet dhe detyrat e përcaktuara të cilat dalin nga prioritetet zhvillimore të programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2015-2019, për vitin 2018 janë në pajtim me Qëllimin strategjik 4 “Mbrojtja e cilësisë së ambientit jetësor”.

Në Raport janë vendosur informacione për: Realizimi i projekteve të miratuara me Vendimin për shpërndarjen e mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore në vitin 2018; Përgatitja e propozim projekteve për zhvillim të rajonit planor për vitin 2019; Organizimi i Mbledhjeve të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor; Azhurnimi i evidencave për potencialet zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor; Pjesëmarrje në aktivitetet e Ministrisë së vetëqeverisjes lokale në procesin e përgatitjes së akteve nënligjore, informacioneve, raporteve dhe materiale tjera të përcaktuara me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal; Përgatitja e Raporteve vjetore për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Raport për punën e Qendrës për vitin 2017; Përgatitja e Propozim Planit aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2018; Organizimi i takimeve, punëtorive dhe vizitave në terren të ndërlidhura me detyrimet ligjore të Qendrës për zhvillim aktivitetet vijuese të ndërlidhura me funksionimin e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në pajtim me detyrimet ligjore, dhe duke i respektuar praktikat e transparencës dhe llogaridhënies për punë, e dorëzoi këtë Raport Vjetor për punën për vitin 2018.

- 1) Realizimi i projekteve të miratuara me Vendim për shpërndarje të mjeteve për financimin e projekteve për zhvillim të rajoneve planore në vitin 2018

Gjatë vitit 2018 Qendra realizoi tre projekte rajonale të financuara përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal. Në afatin e caktuar, deri në fund të muajit nëntor Qendra arriti me sukses t'i realizojë në tërësi projektet: Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturën rrugore në RPJP, Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP dhe Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në RPJP. Vlera e përgjithshme e objekteve të realizuara është 26.005.961 denarë. Detaje për çdo aktivitet në kuadër të projekteve të theksuara janë dhënë në Raportin vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2018.

- 2) Përgatitja e propozim-projekteve rajonale

Për thirrjen publike të Bankës Botërore – Projekt për konkurrencë lokale dhe rajonale, Qendra për zhvillim përgatiti dhe dorëzoi koncept për projektin rajonal – *“Zhvillimi i ofertës gastronomike dhe themelimi i Rrjetit të etno restoranteve nacionale të certifikuara në RPJP”*.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti propozim projekt për financim përmes Shemës së granteve që është pjesë e projektit *“Përmirësimi i qeverisjes komunale”*. Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian dhe realizohet nga ana e zyrës së UNDP në Shkup. Propozim projekti i dorëzuar është *“Studim dhe projekte themelore për ndërtimin e stacionarëve rajonal për*

*qentë endacak në rajonin planor Jugperëndimor”* dhe i njëjti është miratuar për financim. Njësia projektuese në kuadër të UNDP i realizon aktivitetet projektuese dhe deri në fund të vitit 2018 u përgatit dokumentacion tenderik dhe u shpall furnizim publik për përgatitjen e studimit dhe projekteve themelore. Pritet që aktivitetet projektuese të përfundojnë në vitin 2019.

Për thirrjen publike nga Delegacioni i BE-së për bashkëpunimin ndërkufitar mes Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, përveç gatishmërisë dhe diskutimeve të shumta Qendra për zhvillim të RPJP nuk arriti të gjejë komunë partnere nga rajoni planor Jugperëndimor. Kriteret në thirrje ishin të atilla që për të gjitha institucionet që aplikojnë duhej pëlqim nga komuna. Njëkohësisht, sipas kriterëve të thirrjes, nëse një subjekt paraqitet me dy aplikacione mund të financohet vetëm njëra. Për ato shkaqe komunat dëshironin të aplikojnë vetë dhe jo në partneritet me Qendrën.

Për thirrjen publike të Agjencisë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural për vitin 2018, Qendra përgatiti projekt rajonal dhe aplikoi me masën 321 “Zhvillimi i infrastrukturës publike në mjediset rurale” e cila është pjesë e Programit për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset rurale. Projekti u dorëzua në afatet e përcaktuara dhe gjatë vitit 2019 priten rezultatet nga vlerësimi dhe realizimi i tij. Aktivitetet e projektit janë të ndërlidhura me rikonstruktimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore për lidhjen e dy vendbanimeve. Partnerë në projekt janë katër komuna nga rajoni planor Jugperëndimor – Strugë, Debërc, Makedonski Brod dhe Pllasnicë.

Në thirrjen publike të Ministrisë për bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave, për financimin e projekteve përmes Programit për subvencione kapitale për zhvillim të rajoneve planore në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural për vitin 2018, Qendra për zhvillim përgatiti dhe dorëzoi propozim projekt “Përmirësimi i qasjes deri te hapësirat e punueshme në rajonin planor Jugperëndimor”. Partnerë në këtë projekt janë të nëntë komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor.

Qendra për zhvillim të RPJP në pajtim me praktikën e zakonshme organizoi punëtori planifikuese për gjenerim të projekt ideve. Punëtorja u mbajt në 9 tetor 2018 në Strugë, me pjesëmarrje të të gjithë palëve të interesuara – përfaqësues nga komunat, biznes sektori, institucionet arsimore dhe sektori i OJQ nga rajoni Jugperëndimor. U gjeneruan 73 projekt ide të cilat u grupuan sipas qëllimeve strategjike dhe prioriteteve në pajtim me Programin për zhvillim të RPJP, dhe në bazë të atij dokumenti u përgatit propozim lista vjetore për vitin 2019.

Propozim lista u shqyrtua, u radhit dhe u miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Në bazë të listës vjetore të miratuar për vitin 2019 si dhe në bazë të informacionit për mjetet e projektuara për ZHBR për vitin 2019, Qendra përgatiti projekte rajonale. Në pajtim me nenin 34-a, pika 1 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, i dorëzoi deri te Byroja për zhvillim rajonal këto projekte rajonale për vitin 2019:

- 1.Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP, partnerë – Komunat e Strugë, Kërçovës, Ohrit, Debërcës, Dibrës, Qendër Zhupës dhe Vevqanit*
- 2.Rikonstruktimi i rrjetit rrugor aktual dhe ndërtimi i atij të ri në RPJP, partnerë Komunat e Vevqanit, Ohrit, Makedonski Brodit dhe Qendër Zhupës*
- 3.Përgatitja e dokumentacionit teknik për rrugë lokale dhe rajonale, partnerë Komunat e Debërcës, Vevqanit, Strugës, Dibrës dhe Makedonski Brodit*

### **3) Organizimi i mbledhjeve të Këshillit për zhvillim të RPJP**

Deri në fund të vitit 2018 u mbajtën katër mbledhje të Këshillit për zhvillim të RPJP. Në mbledhje u shqyrtua dhe u miratua lista vjetore e projekteve për vitin 2019, Plani aksionar për vitin 2018, Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2017, Raporti vjetor për punën e Qendrës për zhvillim të RPJP për vitin 2017, Raporti financiar me llogaritë vjetore për vitin 2017, Plani financiar për vitin 2019 dhe dokumente tjera në pajtim me detyrimet ligjore dhe kompetencat e Këshillit për zhvillim të RPJP.

#### **4) Azhurnimi i evidencës për potencialet zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor**

Pas përgatitjes së bërë, listat e evidencës u dorëzuan deri te të gjithë komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Gjithashtu u organizuan katër takime pune në Qendrën për zhvillim dhe u bënë vizita në komuna. Në bazë të informacione të grumbulluara nga të gjithë komunat e Rajonit u përgatit Lista e Evidencave për rajonin planor Jugperëndimor. Në pajtim me detyrimet e ndërmarra Lista e evidencave për potencialet zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor u dorëzua deri te Ministria për vetëqeverisje lokale në fund të muajit nëntor.

#### **5) Pjesëmarrje në aktivitetet e Ministrisë për vetëqeverisje lokale në procesin e përgatitjes së akteve nënligjore, informacioneve, raporteve dhe materialeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal**

Gjatë vitit 2018 në të gjitha ftesat për takime pune të dërguara nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale, përfaqësuesit e Qendrës për zhvillim të RPJP morën pjesë aktive. Gjithashtu të gjitha informacionet dhe materialet e kërkuara janë përgatitur dhe dërguar në afatet e caktuara.

#### **6) Përgatitja e Raportit vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2017**

Raporti vjetor u përgatit në fillim të vitit 2018 dhe në të janë përfshirë të gjithë aktivitetet që i ka realizuar Qendra për zhvillim gjatë vitit 2017, në pajtim me Planin aksionar për vitin 2017. Raporti është i përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe të dyja versionet gjuhësore janë dërguar deri te të gjitha Këshillat Komunale në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Gjithashtu raporti vjetor për vitin 2017 u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

#### **7) Përgatitja e propozim Planit aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2018**

Në fillim të muajit janar 2018 u përgatit Plani për furnizime publike për vitin 2018 si dhe Plani aksionar për vitin 2018. Plani aksionar u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim në mbledhjen e tretë që u mbajt në muajin shkurt. Në pajtim me detyrimet ligjore Qendra për zhvillim e përgatiti edhe Planin financiar për vitin 2019 dhe i njëjti u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajoni planor Jugperëndimor në mbledhjen e gjashtë që u mbajt në fund të muajit tetor të vitit 2018.

#### **8) Aktivitete tjera rrjedhëse**

Gjatë periudhës maj-qershor të vitit 2018 përfaqësues të Qendrës për zhvillim të RPJP morën pjesë në Këshillat e komunave të rajonit Jugperëndimor, në të cilët njëra nga pikat të rendit të ditës ishte edhe Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor dhe Raporti financiar për vitin 2017. Gjatë kësaj, u prezantuan shkurtimisht raportet dhe u dha përgjigje pyetjeve nga këshilltarët të ndërlidhura me projektet rajonale në të cilat partnerë janë komunat.

Qendra për zhvillim të RPJP disa herë organizoi manifestime për prezantimin e programeve nga ana e Ministrive. Nga ana e Ekipit nga Sekretariati për çështje Evropiane para Kryetarëve të Komunave dhe përfaqësuesve të komunave, u prezantuan Fondet Evropiane dhe mundësitë për financim të projekteve me rëndësi për vetëqeverisjen lokale. Gjithashtu u organizua eveniment për prezantimin e Programit për zhvillim rural për vitin 2018. Përfaqësuesit e komunave bashkë me përfaqësues nga biznesi sektori, OJQ dhe institucionet arsimore nga rajoni, morën pjesë në punëtorinë për gjenerimin

e projekt ideve për Shemën e granteve në kuadër të projektit “Përmirësimi i qeverisjes lokale” që realizohet nga Zyra e UNDP në Shkup.

Qendra për zhvillim organizoi edhe takime pune me ekipin e UNDP që punon në projektin “Përmirësimi i qeverisjes lokale” dhe përfaqësues nga tre komuna rurale nga rajoni planor Jugperëndimor. Në takimet përfaqësuesit nga Vevqani, Debërca dhe Qendër Zhupa punuan në plane të integruara për zhvillim lokal. Sipas planit për çdo komunë u siguruan mjete për realizimin e një pilot projekti nga planet e integruara të punuara për zhvillim lokal.

Përveç aktiviteteve të përmendura më lartë në periudhën Janar deri në Dhjetor 2018, përveç vizitave të shpeshta të Komunave nga Rajoni për shkaqe të ndryshme, u mbajtën edhe 10 takime me anëtarë të grupeve të profesionistëve nga komunat dhe konsulentëve të angazhuar për projektet që realizohen në këtë vit kalendarik.

Në periudhën Janar deri në Dhjetor 2018 Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti 11 furnizime publike nga të cilat 10 furnizime publike janë realizuar në tërësi, ndërsa njëra u anulua për shkak se nuk kishte asnjë ofertë adekuate. Nga 11 procedurat e përmendura për furnizime publike dy janë procedura të hapura, tetë janë me Kërkesë për grumbullim të ofertave dhe një është me negociim. Nga procedurat me Kërkesë për grumbullim të ofertave dy janë me vlerë të përlogaritur deri në 5.000 Euro, ndërsa gjashtë tjerat janë për punë me vlerë të përlogaritur deri në 50.000 Euro. Nga furnizimet publike të realizuara 9 janë të lidhura me realizimin e projekteve rajonale dhe vetëm dy janë për punën vijuese të Qendrës për zhvillim. Vlera e përgjithshme e marrëveshjeve të nënshkruara për të gjitha furnizimet e kryera është 26.185.258 denarë me TVSH të llogaritur. Furnizimet realizohen në tërësi në formë elektronike përmes Sistemit elektronik për furnizime publike të Byrosë për furnizime publike, dhe të gjitha përfundojnë me ankand elektronik.

Qendra për zhvillim të  
rajonit planor Jugperëndimor